



**USAID**  
NGA POPULLI AMERIKAN  
OD AMERIČKOG NARODA



**REKK** REGIONAL CENTRE  
FOR ENERGY  
POLICY RESEARCH



National  
Association of  
Regulatory  
Utility  
Commissioners

# Procesi Buxhetor për Rregullatorët në Lituani dhe Letoni

nga prof. V.Jankauskas

Prezantuar në

Punëtorinë e NARUC/ERA mbi Rregullimin e Kompanive të  
Shërbimeve Publike në Ekonomi të Tregut

14-16 prill 2008, Prishtinë



Center for  
Energy and Natural Resources

- *Lithuanian NCC* (rregullatori i energjisë) financohet nga buxheti shtetëror
- Në buxhetin kombëtar ndahet një linjë e veçantë buxhetore për të
- Pagat e punonjësve rregullohen nga ligji mbi shërbimin civil (kategoritë, klasat, titujt, niveli i pagave)
- Pagat e komisionerëve rregullohen me një ligj tjetër
- Shpenzimet tjera janë modeste dhe miratohen sipas parimit të standardizimit me agjencitë tjera shtetërore

- NCC i paraqet planin e vet për vitin e ardhshëm Ministrisë së Financave
- MF mund të propozojë zbritjen e ndonjë shpenzimi buxhetor
- Projektbuxheti kombëtar miratohet në Këshillin e Ministrave dhe i prezantohet Parlamentit
- Projektbuxheti diskutohet brenda komisioneve të ndryshme në Parlament dhe NCC ka të drejtë që ndërkohë të kërkojë revidime të mjeteve që i alokohen
- Pas miratimit nga Parlamenti, buxheti kombëtar shndërrohet në ligj, por ndonjëherë ndodh që të rishqyrtohet pas gjashtë muajsh

- NCC disa herë ka parashtruar propozimin që të ndryshohet legjislacioni, për t'i mundësuar sistemin e buxhetit të pavarur
- Kjo ide është përkrahur nga institucione të ndryshme ndërkombëtare
- Ekzistonte edhe precedenti: Autoriteti Rregullativ për Komunikacion ka buxhet të pavarur
- Qeveria nuk deshë që t'i lejojë më shumë liri NCC-së
- Opinioni publik gjithashtu e kundërshtonte këtë (NCC mund të ngrisë tarifën për kompanitë e shërbimeve publike, në mënyrë që të ketë buxhet më të lartë)

- Komisioni i Kompanive të Shërbimeve Publike në Letoni (rregullator i shumëfishtë) financohet nga pagesat që kryhen nga ndërmarrjet e rregulluara
- Norma vjetore e këtyre pagesave nuk mund të kalojë 0.2% të qarkullimit neto në vitin financiar paraparak, të kompanive të rregulluara që ofrojnë shërbime publike
- Sipas ligjit mbi rregullatorët, Këshilli i Ministrave përcakton çdo vit normën e tarifës për rregullimin e kompanive të shërbimeve publike për secilin lloj ndaras
- Zakonisht norma e tarifës për të gjitha llojet e kompanive të shërbimeve publike përcaktohet në 0.2% të qarkullimit neto të shërbimit të rregulluar në vitin paraparak
- Në sektorin e hekurudhave, tarifa për shërbimet publike të infrastrukturës hekurudhore për kargo bartësit është 0.1%

- Rregullat e pagesës në buxhetin e Rregullatorit përcaktohen me Vendimin e Këshillit të Ministrave të Letonisë, të datës 29 dhjetor 2004
- Të gjitha kompanitë e rregulluara paguajnë 0.2% të qarkullimit të tyre në vitin paraprak
- Nëse kompanitë e rregulluara kryejnë disa aktivitete të rregulluara, totali i pagesës nuk do të duhej të kalojë normën prej 0.2%
- Pagesat duhet bërë në katër pjesë të barabarta deri më 10 janar, 10 prill, 10 korrik dhe 10 tetor
- Çdo vit, deri në datën 30 janar, duhet të realizohet një pagesë nga kompanitë e rregulluara përmes të cilës bëhet përputhja e shumës së paguar me proporcionin gjegjës të qarkullimit real